VENDIM
Nr. 82, datë 19.3.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "HYDROSOLAR ENERGY (HSE)" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 828/1 prot., datë 18.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Hydrosolar Energy (HSE)' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828 prot., datë 5.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, për pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave "a", "b" dhe "c", duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1;

- Në përputhje me nenin 9, për pikën 1.2, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave "a" dhe "d";

- Në përputhje me nenin 9, për pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave "a" dhe ""c".

- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave "b", "c" dhe "d".

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Rezulton se shoqëria "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k.:

- ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 188 rep., nr. 413 kol., datë 10.2.2026, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria 'Hydrosolar Energy' sh.p.k.";

- Është pajisur me miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. nr. 3381/3 prot., datë 4.7.2025;

- Është pajisur me Vendim VNM Paraprake, lëshuar më 9.7.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit "Impiantit Fotovoltaik", me kapacitet 2 mw.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "b": aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për vetë shoqërinë;

- germa "c": aplikuesi duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me stafin teknik efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion të përditësuar në lidhje me mbështetjen financiare;

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa "a": shoqëria duhet të saktësojë jetëgjatësinë e pritshme të centralit dhe të përcaktojë datë konkrete kur parashikon të fillojë operimi i centralit, si dhe të depozitojë një garanci për panelet që do të përdorë, në rast se ka;

- germa "e": Rezulton se shoqëria disponon një VNM të vlefshme deri më 9.7.2027, por duke qenë se në shtojcën 2 ka deklaruar se viti i ndërtimit është viti 2026 dhe vetë nuk ka paraqitur ndonjë informacion në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, vlerësohet që t'i kërkohet shoqërisë ky informacion në vijim. Po ashtu, vlerësohet t'i kërkohet të bëjë saktësimin përkatës të koordinatave, në lidhje me vendndodhjen e projektit, në referencë të kontratës me MIE-n.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Hydrosolar Energy (HSE)" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti